



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM-VE

Nr. 9686/ prot

Tiranë, më 15.09 2025

Lënda: Kthim përgjigje.

“MEDI - TEL” SHPK ✓

“Tiranë, Kashar, Mëzez, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 1, Rruga Vidhëgjatë, ndërtesa
Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr. pronësie 41/1/16/2”

Në përgjigje të kërkesës suaj regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me Nr. 9686 Prot., datë 09.09.2025, me lëndë: “Kërkesë për ndryshim të kushteve të lejes”. Ju bëjmë me dije se:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton operatorin “MEDI - TEL” të vijojë me aplikimin për ndryshim të kushteve të lejes mjedisore të tipit A me PN-3194-06-2016, sipas kreut V, të VKM-së Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”.

Operatori i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, kërkesën, nëpërmjet QKB-së (portalit qeveritar e-albania), referuar Ligjit Nr.10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.

